



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më _____.____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Riparim elektromotorash dhe Transformatorësh”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve 50532200-5

Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e gjeneratorëve 50532300-6

VLERA E FONDIT LIMIT:

9.502.666 (nente milion e peseqind e dy mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqërija Rajonale Ujësjetellesh Kanalizime Fier”, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1.2 Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare(2020-2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure,si dhe bazuar nënenin 77 pika 3 i LPP,si dhe nenin 43pika 1 tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërëbazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2021-2022) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Ky kriter do te përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Sqarim:

Në zbatim të Ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, si dhe të njoftimit të përbashkët të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe APP, respektivisht me nr. 25366 prot dhe nr.8480 prot, datë 30.12.2020, njoftojmë operatorët ekonomikë pjesëmarrës që për nënshkrimin e kontratës publike, në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.

Kopje të Çertifikatës elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Çertifikuar për zgjidhjen softëare-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike".

➤ 2.3 Kapaciteti teknik:

- Për kapacitetin teknik operatori ekonomik duhet të paraqesë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen **dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tri viteve të fundit (2020-2021-2022), me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Arsyetimi: Pika 2.3.1 është vendosur bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020“Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/“c” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 41 pika 3. Ky kriter vendoset për të vërtetuar se operatorët ekonomik i zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike, logjistikën e duhur , për ta realizuar objektin e prokurimit me sukses pasi edhe më përpara kanë realizuar furnizime të ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- a) Numri mesatar i punonjësve të siguruar /të kualifikuar për tre muajt e fundit, të jetë **jo më i vogël se 6 punonjës** të përhershëm për muaj, të punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik,
- b) Listë pagesat mujore të miratuara nga Administrata Tatimore për periudhen e mësipërme, ku të figurojë i siguruar, **drejtuesi teknik** i operatorit ekonomik.
- c) **Inxhinier Elektrik 1(një)**

Pranohet edhe mundësia e disponimit të punonjësve të kerkuar edhe nëpërmjet kontraktimit.

Arsyetimi: Pika 2.3.2 është vendosur bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020“Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/”a” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 41 pika 4/“c”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si vijon:

Për Stafin teknik të kërkuar si më poshtë, të paraqiten: kualifikime të arsimimit dhe kualifikime profesionale (CV, diploma, kontratat e punës të noterizuara, të vlefshme për të gjithë kohën e ekzekutimit të kontratës, *dëshmi aftësie dhe licencat përkatëse si:*

1.Diplomë Fakulteti Inxhinieri Elektrike

2.Licencë zbatimi, kategoria 13 pikat C, D, E) gjithashtu të jenë të siguruar për tre muajt e fundit, të punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik (22 ditë pune) sipas funksionit të tyre.

Arsyetimi: Pika 2.3.3 është vendosur bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 41 pika 4/“b”. Ky kriter i shërben AK për të gjykuar nëse operatorët ekonomik janë të përshtatshëm për të kryer veprimtarinë profesionale sipas kërkesave të këtij prokurimi.

2.3.4 Të ketë në pronësi ose me qera officinë mekanike/repart pune me pajisjet teknike, elektro-mekanike dhe axhusterike të domosdoshme për kryerjen e riparimeve të elektromotorëve dhe transformatorëve. Çertifikata e pronësisë ose kontrata noteriale e qerasë, të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohës së ekzekutimit të kontratës.

2.3.5 Të zotërojë Makineritë dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi ose me qera.

Pranohet marrja me qera ose huapërdorje e këtyre mjeteve, me kusht që kontrata/t e qiramarrjes ose huapërdorjes, të jenë të noterizuara dhe të vlefshme gjatë kohës së ekzekutimit të kontratës.

- a) *Furre vakumi* për tharjen e transformatorëve dhe elektromotorëve copë 1(një)
- b) *Vinç ure* i lëvizshëm për ngritjen e pajisjeve me peshë mbi 10 ton copë 1(një)
- c) *Pajisje për balancimin* dinamik të rotorave copë 1(një)
- d) *Bobinatricë* për avolzhimin e bobinave të transformatorëve me përmasa, gjatësi deri në 3 metra dhe diametër deri në 2.5 m copë 2(dy)
- e) *Presë-vakum filtër* për qarkullimin e vajit dhe filtrimin e tij copë 1(një)
- f) *Vend për llakimin* e bobinave dhe të elektromotorëve copë 1(një)
- g) *Furrë tharje* me rezistenca copë 1(një)
- h) *Laborator* për kryerjen e matjeve të nevojshme dhe matjen përfundimtare copë 1(një)

Arsyetimi: Pikat 2.3.4 dhe 2.3.5 janë vendosur bazuar në Ligjin nr.162 datë 23.12. 2020“Për Prokurimin Publik” neni 77 pika 1/“c” dhe në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” neni 41 pika 4/ “ç”. Ky kriter vendoset për të garantuar që një kandidat ose ofertues, të ketë kapacitetet dhe aftësitë teknike e profesionale, për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat, duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

REFERENCAT TEKNIKE

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1.	Elektromotor 680 KW	cope	1
2.	Elektromotor 55 KW	cope	10
3.	Transformator fuqie 160 KVA	cope	1
4.	Transformator fuqie 50 KVA	cope	1
5.	Transformator fuqie 100 KVA	cope	1
6.	Transformator fuqie 500 KVA	cope	1
7.	Elektromotor 440 KW	cope	1
8.	Elektromotor 18.5 KW	cope	1
9.	Elektromotor 22 KW	cope	1
10.	Elektromotor 7.5 KW	cope	1
11.	Transformator fuqie 400 KVA	cope	2
12.	Elektromotor 135 KW	cope	1
13.	Elektromotor 110 KW	cope	1
14.	Elektromotor 90 KW	cope	1
15.	Elektromotor 135 KW	cope	1
16.	Elektromotor 15 KW	cope	1
17.	Elektromotor 2.2 KW	cope	1

- *Të bëhet balancimi i rrotorit.*
- *Të ndërrohen kushinetat.*
- *Të shoqërohet me fletën e matjes së rrymave gjatë provës së lëshimit të elektromotorit pa ngarkesë.*
- *Matja e rezistencave të ilacionit të 3 fazave (të shoqërohet me fletën përkatëse).*
- *Matja e rezistencave omike të pësjtjellës (të shoqërohet me fletën përkatëse).*
- *Të ketë garanci 1-vjecare nga dita e vënies në punë*
- *Në momentin e vënies në punë, një nga punonjësit e kontraktorit (ofruesi i shërbimit) të jetë prezent.*

❖ **Grafiku i lëvrimit:**

Sipas kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier SH.A. Përparësi do t'i jepet riparimit të 1 elektromotori TM me fuqi 680 KW dhe tre prej elektromotorëve TU 55 KW 400V, të cilët do të riparohen gjatë 3-mujorit të parë, nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Pjesa tjetër do të riparohet sipas nevojave dhe rrethanave të proceseve të punës.

❖ **Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:**

Riparim Elektromotorësh TU dhe Transformatorësh për 12 muaj.

Detyrat (transformator): Ofruesi i shërbimit ka për detyrë të bëjë provat e mëposhtme për transformatorin para, gjatë dhe pas riparimit:

- Matje e rezistencës së izolimit nepermjet përshtjellave dhe ndermjet pështjellave dhe bërthamës magnetike.
- Matje e koefiçentit të absorbimit.
- Matje e rezistencës së izolimit të prixhonerëve me nuklin e transformatorit.
- Matje e rezistencës omike të pështjellave.
- Matje e koefiçentit të transformimit.
- Matje e grupit të lidhjeve.
- Matje e rrymave të rrjedhjes.
- Matje e tagent deltës së pështjellave.
- Matje e tagent deltës së izolatorëve.
- Prova e punimit pa ngarkesë.
- Prova e qëndrueshmërisë elektrike midis spirave duke e ushqyer transformatorin me 130% të tensionit nominal.
- Prova e lidhjes së shkurtër.
- Prova e pështjellave me tension të rritur.
- Prova 72 orëshe me ngarkesë në vendin e punës.
- Prova e qëndrueshmërisë elektrike të vajit.

Detyrat (elektromotor): Ofruesi i shërbimit ka për detyrë të bëjë provat e mëposhtme për elektromotorat para, gjatë dhe pas riparimit:

- Matje e rezistencës së izolimit nëpërmjet përshtjellave dhe ndermjet pështjellave dhe bërthames magnetike.
- Matje e rezistencës së izolimit.
- Matje e rezistencës omike të përshtjellave.
- Matje PI (polarisation index) me meger elektronik.
- Matje e rrymave të rrjedhjes.
- Prova e punimit pa ngarkesë.
- Prova 72 orëshe me ngarkesë në vendin e punës.

Shënim:

Provat para dhe pas riparimit të elektromotorrëve, do të bëhen në praninë e përfaqesuesve me autorizim te Shoqerise Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier SH.A, me të cilët do të mbahet një procesverbal për defektin e konstatuar para riparimit dhe një procesverbal për defektin e riparuar pas riparimit.

Pas riparimit dhe marrjes në dorëzim nga Shoqerise Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier SH.A, pjeset e vjetra të dëmtuara do të dorëzohen sipas preventivit në kompaninë tonë me një procesverbal të vecantë.

Dorëzimi i mallit nga ofcina riparuese përkatëse do të bëhet përmes Akt-testimit dhe Akt-kolaudimit sipas standarteve në fuqi për secilën pajisje.

Ofertuesi duhet të lëshojë fletë-garanci për 1 vit për cdo elektromotor të riparuar.

Periudha e garancisë do të fillojë nga momenti i vënies në punë të elektromotorëve të riparuar në Shoqerise Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Fier SH.A.

NJËSIA E PROKURIMIT
